



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
**Kuvendi i Komunës Rahovec**  
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY	
RAHOVEC / ORAHOVAC	
Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)	
Nr./Br./No <u>128</u> Nr. i faq/Br.str./No.pg <u>01/23</u>	
Data/Datum/Date <u>30/08/2023</u>	

## STATUTI I ANSAMBLIT TË KOMUNËS SË RAHOVECIT

2023

Gusht-2023

## **STATUTI I ANSAMBLIT TË KOMUNËS SË RAHOVECIT**

### **Neni 1.**

Me këtë statut përkufizohet funksionimi i veprimtarisë së ansamblit të këngëve dhe valleve i komunës së Rahovecit

### **Neni 2.**

Shprehjet e përdorura në këtë statut kanë këtë përkufizim:

- 2.1. Ansambla i Komunës së Rahovecit – është institucion i themeluar nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit dhe ka si objekt veprimtarie zhvillimin e artit skenik, ruajtjen e trashëgimisë kulturore – shpirtërore të rajonit të Rahovecit e më gjerë, realizimin e veprave skenike, kultivimin dhe ruajtjen e vlerave kombëtare etnomuzikologjike e etnografike, si dhe promovimin e këtyre vlerave brenda dhe jashtë vendit.
- 2.2. Ansamblet komunale (Shoqëritë kulturore-artistike) – shoqëri kulturore-artistike publike, veprimtaria e të cilave synon realizimin e aktiviteteve kulturore të shprehura me këngë, valle e koreografi skenike që ruajnë dhe kultivojnë vlerat kombëtare, me theks të veçantë të zonës së Rahovecit.
- 2.3. Ansamblet private – organizata jo-qeveritare dhe organizata profitable që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në bazë të statutit sipas ligjit dhe rregullores së MAP për funksionimin e OJQ-ve.
- 2.4. Trupë artistike – emërtim për stafin udhëheqës artistik; valltarët, solistët vokal dhe orkestrën.
- 2.5. Fondusi – tërësia e kostumeve, instrumenteve muzikore, rekuizitave, elementeve skenografike, si dhe mjeteteve e materialeve teknike me vlera etnomuzikologjike e etnografike.

## **KREU II**

### **LLOJET, THEMELIMI, VEPRIMTARIA, ORGANIZIMI, FINANCIMI DHE STATUSI I ARTISTËVE**

#### **Neni 4**

##### **Lloji i ansamblit**

1. Ansamlet mund të jenë; publike dhe private
  - 1.1. Ansamble komunale
  - 1.2. Ansamble private

#### **Neni 5**

##### **Themelimi i ansamblit**

- 5.1 Ansamlli Komunal themelohet me vendim të Kuvendit të Komunës së Rahovecit
- 5.2. Ansamlet private mund të themelohen nga personat fizik dhe juridik në bazë të ligjit dhe rregulloreve për funksionimin e OJQ-ve

#### **Neni 6**

##### **Veprimtaria e Ansamblit Komunal**

- 6.1. Ansamlli Komunal themelohet dhe financohet nga Kuvendi i Komunës dhe Ekzekutivi i Komunës së Rahovecit
- 6.2. Ansamlli ruan dhe kultivon traditat kombëtare, me theks të veçantë traditat etnomuzikologjike e etnografike të rajonit të Rahovecit
- 6.3 Ansamlli të paktën dy herë në vit përgatit dhe shfaq program artistik – skenik
- 6.4. Ansamlli komunal mund të marrë pjesë në aktivitete kulturore brenda dhe jashtë vendit, me qëllim të promovimit të vlerave etno-kulturore të rajonit të Rahovecit.
- 6.5. Bën mbledhjen, konservimin dhe arkivimin e lëndës muzikore të traditës shpirtërore e materiale popullore, si dhe nxitjen, zhvillimin, publikimin dhe promovimin e artit kombëtar brenda dhe jashtë vendit.
- 6.6. Bën përgatitjen, ngritjen artistike, promovimin, edukimin dhe prezantimin e kuadrove të reja.

#### **Neni 7**

##### **Organizimi i Ansamblit Komunal**

- 7.1. Ansamlli i Këngëve dhe Vallëve Rahoveci, ka emërtimin zyrtar dhe formën e shkurtër të përdorimit të emrit. Emërtimi zyrtar i këtij institucioni është: "Ansamlli i Këngëve dhe Vallëve Rahoveci", ndërsa emërtimi në formën e shkurtër/akronimi është "AKV Rahoveci".
- 7.1. Ansamlli Komunal është institucion komunal i kulturës popullore me seli në Rahovec.

7.2. Ansambi Komunal ka simbolet e veta dhe shenjat dalluese me karakter artistik, AKV Rahoveci ka Logon, Vulën e rrumbullakët dhe Vulën katrore.

7.3. Organizimi dhe funksionimi i Ansamblit Komunal rregullohet me këtë statut dhe aktet tjera nënligjore, në pajtim me ligjet e Republikës së Kosovës që e përkufuzojnë mënyrën e funksionimit të ansambleve artistike.

#### 7.4. Struktura organizative e Ansamblit Komunal

7.4.1. Këshilli drejtues

7.4.2. Drejtori

7.4.3. Këshilli artistik

7.4.4. Udhëheqësi artistik

#### Neni 8

##### Këshilli Drejtues i Ansamblit Komunal

8.1. KDAK përbëhet prej pesë (5) anëtarëve, me mandat katervjeçar dhe preferohet të jenë profesionistë të fushës së artit skenik muzikor, etnomuzikolog dhe të fushave relevante të artit.

8.2. Këshillin Drejtues përbëhet nga: Një (1) anëtarë nga ekzekutivi, një (1) anëtarë nga shoqëria civile dhe tre (3) anëtarë nga kuvendi, të emëruarit e KD i mbikëqyr Kryetari i Komunës së Rahovecit.

8.3 Njëri nga anëtarët e KD duhet të jetë i emëruar nga Kryetari dhe të jetë i deleguar nga Ekzekutivi i Komunës, por nuk ka të drejtë të jetë kryetar i KD të Ansamblit.

8.4. Kryetari i KD zgjedhet nga pesë anëtarët e emëruar të Këshillit Drejtues me shumicën e votave

8.5. Anëtarët e KD kompensohen për punën e tyre sipas ligjit dhe rregulloreve komunale.

#### Neni 9

##### Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit drejtues

9.1. KD harton dhe miraton politikat zhvillimore të Ansamblit Komunal.

9.2. harton dhe miraton planin vjetor të punës së Ansamblit.

9.3. përgatit dhe miraton raportin vjetor të punës dhe atë financiar dhe raporton pranë organeve kompetente komunale.

9.4. harton dhe miraton rregulloren e brendshme të punës së Ansamblit.

9.5. zgjedh dhe shkarkon kryetarin e KD të Ansamblit.

9.6. zgjedh dhe shkarkon udhëheqësin artistik të Ansamblit.

9.7. Bashkëpunon ngushtë me DKRS-në dhe autoritetet tjera komunale.

9.8 Raporton pranë DKRS-së dhe autoriteteve të tjera përkatëse komunale (Kuvendi dhe Ekzekutivi).

#### **Neni 10**

##### **Drejtori i Ansamblit Komunal**

- 10.1. Drejtori është udhëheqës dhe organ ekzekutiv i Ansamblit.
- 10.2 Drejtori i Ansamblit zgjedhet me konkurs publik të shpallur nga Ekzekutivi i Komunës.
- 10.3. Drejtori i Ansamblit duhet të ketë diplomë universitare në fushën e artit, kulturës, etnomuzikologjisë, apo ndonjë fushë tjetër relevante që lidhet me trashëgiminë kulturore.
- 10.4. Drejtori i Ansamblit zgjedhet me mandat katërvjeçar, me mundësi rizgjedhjeje.

#### **Neni 11**

##### **Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtitorit të Ansamblit**

- 11.1. Drejtori udhëheq, organizon, mbikëqyr veprimtarinë dhe funksionimin e Ansamblit.
- 11.2. I raporton Këshillit drejtues për planin vjetor të punës dhe planin financiar.
- 11.3. Merr pjesë në mbledhjet e Këshillit drejtues, pa të drejtë vote.
- 11.4. Përfaqëson Ansamblin brenda dhe jashtë vendit.
- 11.5. Kërkon dhe negacion marjen e donacioneve, si dhe përgjigjet për menaxhimin e tyre.
- 11.6. Informon me gojë dhe me shkrim drejtorin e DKRS-së dhe autoritet tjera komunale për ecurinë dhe mbarëvajtjen e punëve në Ansambël.
- 11.7. Ushtron detyra të tjera me përgjegjësi në përputhje me detyrat dhe obligimet ligjore.

#### **Neni 12**

##### **Këshilli artistik i Ansamblit**

- 12.1. Këshilli artistik i Ansamblit ka pesë anëtarë dhe përbëhet nga;
  1. Udhëheqësi artistik i Ansamblit
  2. Koreografi
  3. Koreopetitori
  4. Përgjegjësi i sektionit të solistëve vokal
  5. Përgjegjësi i sektionit të orkestrës.
- 21.2. Udhëheqësi Artistik është kryesues i Këshillit artistik.

## Neni 13

### Detyrat dhe përgjegjësitë e Udhëheqësit Artistik

- 13.1. Udhëheqësi Artistik i Ansamblit Komunal ka këto detyra;
- harton dhe i propozon drejtorit programin artistik vjetor;
  - bën vlerësimin artistik të koncerteve dhe aktiviteteve të tjera kulturore, si dhe jep këshilla për konceptin e programit të Ansamblit;
  - miraton programin e shfaqjeve artistike;
  - përkujdeset për prezantimin sa më të mirë të vlerave artistike të trashëgimisë shpirtërore e materiale;
  - vlerëson dhe miraton pikat artistike të programit premierë;
  - bën vlerësimin vjetor profesional të valltarëve, solistëve vokal dhe instrumenteve.

## Neni 14

### Përgatitja dhe mandati i Udhëheqësit Artistik të Ansamblit

- 14.1. është përgjegjës profesional i Ansamblit me përgatitje profesionale univesitare në fushën e arteve skenike – muzikore, etnomuzikologjike;
- 14.2. Zgjedhet me konkurs publik të shpallur nga ekzekutivi i komunës së Rahovecit.
- 14.3. duhet të ketë përvojë pune dhe aftësi profesionale në fushën përkatëse të arteve skenike.
- 14.4. Mandati i Udhëheqësit Artistik është katërvjeçar, me mundësi rizgjedhjeje.

## Neni 15

### Financimi i Ansamblit Komunal

- 15.1. Ansamblı Komunal financohet nga buxheti i komunës së Rahovecit.
- 15.2. Ansamblı mund të konkurrojë në thirrjet publike të MKRS-së për mbështetje të projekteve të caktuara të Ansamblit.
- 15.3. Ansamblı mund të sigurojë edhe fonde të tjera nga individ fizik e juridik, biznese dhe organizata të tjera vendore e ndërkombëtare.
- 15.4. Drejtori i Ansamblit i raporton Ekzekutivit dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit përményrën e shpenzimit të buxhetit.

## Neni 16

### Lënda arkivore e Ansamblit

- 16.1. Ansamblı obligohet që ta ketë fondin e vet arkivor dhe ta ruajë e sistemojë në përputhje me ligjin dhe rregulloret në fuqi.
- 16.2. Nëse Ansamblı pushon së funksionuari, atëherë lënda arkivore i kalon arkivit komunal.

**Neni 17**

**Fondusi i Ansamblit Komunal**

- 17.1. Ansambli Komunal ka fondusin e vet dhe anëtarët e drejtuesit e ansamblit janë të obliguar ta ruajnë, të kujdesen dhe ta mirëmbajnë fondusin e ansamblit; kostumet, instrumentet muzikore, rekuizitat, elementet skenografike, si dhe materialet tjera me vlera etnomuzikologjike, etnografike dhe të kulturës populllore.
- 17.2. Nëse Ansambli pushon së funksionuari, atëherë i gjithë fondusi dhe materialet tjera të Ansamblit i kalojnë muzeut komunal në Rahovec.

**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

**NENI 18**

- 18.1. Ky statut hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovcit
- 18.2. Autoritet komunale ekzekutive kanë afat gjashtë muaj për përfundimin e procedurave ligjore për formimin e Ansamblit Komunal të Komunës së Rahovcit.
- 18.3. Ky statut hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovcit.

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

01-Nr.128/23

Më datë:30.08.2023

